



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 431 Prot.

Tiranë, më 29.12.2020

V E N D I M

Nr.217, datë 29.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 16, datë 19.02.2020, të Komisionit të Ristrukturimit, për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit *** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 431 prot., datë 26.05.2020, nëpunësi *****, ka parashtruar pretendimin se vendimi nr. 16, datë 19.02.2020, i Komisionit të Ristrukturimit, “Për konstatimin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit”, nga pozicioni “Specialist”, në Drejtorinë e Punëve Publike, Urbanistikës dhe Emergjencave Civile, është nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2016, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezultojnë të vërtetuar që: Në zbatim të nenit 67/3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kërkuesi ***** është deklaruar nëpunës civil dhe më tej, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit për lëvizje paralele, me aktin nr. 2348 prot., datë 18.04.2016, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Gjirokastrë, është emëruar në pozicionin “Specialist për

kontrollin e projekteve arkitektonike dhe urbanistike”, në Sektorin e Shërbimeve Urbane, në Drejtorinë e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit, me kategori page III-b.

Shkaku i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi lidhet me veprimet administrative të kryera pas implementimit të urdhrin nr. 35, datë 21.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, “*Për miratimin e organigramës së administratës së Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2020*”, me anë të së cilës është përcaktuar numri i përgjithshëm i personelit të këtij institucioni dhe është miratuar struktura e re e tij. Mbi këtë bazë, me urdhrin nr. 96/1, datë 12.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit, pas shqyrtimit dhe analizës së ndryshimeve strukturore, dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, si dhe kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për pozicionet e reja të krijuara, pasi ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të nëpunësve civilë pozicionet e të cilëve janë prekur për shkak të ristrukturimit dhe ndër të tjera, me aktin nr. 1295 prot., datë 12.02.2020, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin *****, duke njoftuar për këtë vendim edhe njësinë përgjegjëse të institucionit.

Në përmbajtje të akteve të mësipërme, vërehet se përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për këtë nëpunës, është diktuar nga fakti që pozicioni i mëparshëm i këtij nëpunësi “*Specialist për kontrollin e projekteve arkitektonike dhe urbanistike*”, në Sektorin e Shërbimeve Urbane, në Drejtorinë e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit është suprimuar dhe se transferimi i tij në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori nuk ka qenë i mundur për shkak të shkurtimit të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të shërbimit civil dhe kualifikimit të tij specifik arsimor.

Rezulton e vërtetuar se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, e ka njoftuar nëpunësin për vendimmarrjen e mësipërme me aktin nr. 1653 prot., datë 21.02.2020, “*Njoftim vendimi*”. Në këto rrethana, nëpunësi *****, duke mos qenë dakord me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, ka paraqitur ankim më datë 24.02.2020 pranë njësisë përgjegjëse të Bashkisë Gjirokastrë (*protokolluar me nr. 1659 prot., datë 24.02.2020*), duke kërkuar shfuqizimin e vendimit dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm.

Pasi është shqyrtuar ankesa e paraqitur, duke patur parasysh gjithë rrethanat personale e familjare të këtij punonjësi, njësia e burimeve njerëzore të bashkisë Gjirokastrë, nëpërmjet vendimit nr. 49, datë 21.04.2020, “*Për transferim të përhershëm*”, nëpunësi në fjalë është emëruar në pozicionin “*Inspektor*”, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit (IMT).

Edhe ndaj aktit të mësipërm të transferimit, nëpunësi ***** ka paraqitur ankim, nëpërmjet shkresës me nr. 3223, datë 28.04.2020, duke parashtruar se transferimi i tij është bërë në një pozicion jashtë shërbimit civil, fakt që vjen në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Njësia e Burimeve njerëzore, me shkresën nr. 3223/1 prot., datë 08.05.2020, “*Kthim përgjigje*”, duke iu referuar dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka sqaruar se transferimi i nëpunësit *****, në një pozicion pune me funksione administrative (*për të cilin marrëdhënia juridike e punësimit gjen rregullim në dispozitat e Kodit të Punës*), është kryer në kushtet e pamundësisë të sistemimit të tij në një pozicion të shërbimit civil, pas suprimimit të vendit të mëparshëm të tij të punës dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Nga sa më sipër, në vlerësim të fakteve, rrethanave të çështjes dhe dokumentacionit të administruar e të përshkruar më sipër, arsyetohet si më poshtë:

Dispozita e pikës 1, të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, përcakton se: “*Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori*”. Sipas kësaj dispozite, ligjshmëria e procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësit civil kërkon ekzistencën e dy kushteve, të mëposhtme:

- a) *pozicioni i mëparshëm të mos ekzistojë më, çka nënkupton të jetë suprimuar, shkurtuar ose riorganizuar dhe,*
- b) *nëpunësi civil, pozicioni i të cili preket nga strukturimi, duhet të transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.*

Nga përmbajtja e materialit të dërguar nga Bashkia Gjirokastrë, konstatohet se Drejtoria e Punëve Publike, Urbanistikës dhe Emergjencave Civile, në të cilën ushtronte detyrën nëpunësi *****, sipas strukturës së mëparshme, ishte e organizuar me **1** pozicion “*Drejtor*”, **3** pozicione “*Përgjegjës Sektori*” dhe **11** pozicione “*Specialist*” (në total 15 pozicione). Aktualisht, me miratimin e strukturës së re, me urdhrin nr. 35, datë 21.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë, kjo drejtori ka ndryshuar emërtesë në “*Drejtori të Urbanistikës*” dhe njëkohësisht rezulton të jetë riorganizuar. Konkretisht, rezulton se kjo drejtori organizohet me **1** pozicion “*Drejtor*”, **2** pozicione “*Përgjegjës Sektori*” dhe **7** pozicione “*Specialist*”.

Nga krahasimi i dy strukturave, konstatohet se në këtë rast kemi një shkurtrim real të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të kësaj njësie organizative, konkretisht janë shkurtuar 1 pozicion “*Përgjegjës Sektori*” dhe 4 pozicione “*Specialist*”. Njëkohësisht vlen të theksohet se të vetmet pozicione të nivelit ekzekutiv që vazhdojnë të ekzistojnë në strukturën e re, janë pozicionet “*Specialist mjedisi*” dhe “*Specialist për hartimin e projekteve dhe detyrave të projektimit në investimet publike*”, ndërkohë që pozicionet e tjera të nivelit ekzekutiv, janë riorganizuar, fakt që nënkupton se në këto raste ka shtim/pakësim të kompetencave dhe detyrave funksionale, si dhe ndryshim të përshkrimeve të punës e kërkesave të veçanta.

Nga sa është parashtruar më sipër, konstatohet ekzistenca e kushtit të parë, pasi ristrukturimi e ka prekur pozicionin në të cilën ka qenë i punësuar ankuesi si “*Specialist kontrolli projekteve*”

nga ana arkitektonike/urbanistike”, në Sektorin e Shërbimeve Urbane, në Drejtorinë e Punëve Publike, Urbanistikës dhe Emergjencave Civile, pasi ky pozicion është suprimuar.

Në vijim të verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, rezultoi se, në zbatim të nenit 50, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreut II, pika 18, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të nëpunësit civil *****, në ndonjë nga vendet e lira ekzistuese ose të krijuara, bazuar në kriteret specifike të këtyre pozicioneve si dhe të dhënat personale të nëpunësit.

Komisioneri vëren se në këtë rast, Komisioni i Ristrukturimit i ka mbajtur parasysh kërkesat e parashikuara në Kreun II, pika 19, të aktit nënligjor të sipërcituar, siç janë: a) vjetërsia e nëpunësit civil në shërbimin civil; b) vlerësimet e rezultateve në punë dhe c) vlerësimi i fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitim dhe për përditësimin e njohurive shtesë dhe dispozitat e përcaktuara në udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të DAP, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”* dhe në pamundësi për ta sistemuar atë në një pozicion të shërbimit civil të së njëjtës kategori, për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor të atyre pozicioneve të mbetura të lira apo të ristrukturuara, me vendimin nr. 16 dt. 19.02.2020 ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për këtë nëpunës.

Nisur nga ky zhvillim i ngjarjeve, duke mos bërë drejt dallimin ndërmjet konceptit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil dhe konceptit të përfundimit të marrëdhënies së punës, njësia e burimeve njerëzore nuk ka nxjerrë aktin administrativ sipas përcaktimeve të nenit 66, pika 1, germa a/1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreut III, pika 24, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, i ndryshuar, për lirin nga shërbimi civil të këtij nëpunësi. Kjo, vlerësohet si një mangësi në punën e kësaj njësie në trajtimin e këtij rasti, e cila duhet të plotësohet menjëherë, me nxjerrjen e aktit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Në rast se njësia e burimeve njerëzore do të kishte nxjerrë aktin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, do të merrte masa edhe për zbatimin e pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, sipas së cilës, kur një nëpunës civil përfundon marrëdhënien në shërbimin civil, për shkak të shkurtimit të vendit të punës apo mbylljes së institucionit, *“...ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas rasteve të mëposhtme:*

- a) *deri në një vit eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 1 muaji...etj” (citim i pjesshëm, shih dispozitën, më tej)... dhe deklarimin e të drejtës që parashikon pika 8 e kësaj dispozite.*

Ndërkohë, drejtuesi i Bashkisë Gjirokastrë, duke pasur parasysh kushtet personale e familjare të këtij nëpunësi, me aktin nr. 49 dt. 21.04.2020, ka vendosur sistemimin e tij në pozicionin *“Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit”*, pozicion që ai e ka pranuar dhe në të cilin punon aktualisht.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil thekson se, në llogaritjen e dëmshpërblimit duhet të mbahet parasysh zbritja e periudhës dy mujore, të paguar nga momenti i ditës kur duhej nxjerrë akti i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil nga njësia përgjegjëse, deri në emërimin e tij të ri, me aktin e Kryetarit të Bashkisë nr. 49 dt. 21.04.2020, kur nëpunësi ka filluar të paguhet sipas vendit të ri të punës.

Në lidhje me aktin e mësipërm të Kryetarit të Bashkisë, ndonëse është i ligjshëm pasi është nxjerrë nga një organ publik brenda kompetencave të tij, Komisioneri parashtron se referenca ligjore dhe emërtimi i aktit *“Për transferim të përhershëm brenda shërbimit civil”* është i pasaktë, pasi nëpunësi në fjalë, pas vendimit të Komisionit të Ristrukturimit nuk ishte më pjesë e shërbimit civil dhe për më tepër, pozicioni *“Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit”* ku u emërua, nuk është pjesë e shërbimit civil. Në këto kushte, akti i emërimit duhet të kishte për referencë vetëm dispozitat e Kodit të Punës dhe ato të organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor.

Nisur nga sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se pavarësisht mangësive apo pasaktësive në aktet e cituara, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin *****, në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Gjirokastrë, në thelb është trajtuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit civil, për këtë arsye pretendimet e tij nuk konsiderohen të drejta dhe për pasojë kjo çështje duhet të arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 16, pika 6, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Gjirokastrë, mbi bazën e vendimit nr. 16, datë 19.02.2020, të Komisionit të Ristrukturimit, të nxjerrë aktin administrativ nëpërmjet të cilit të deklaroj lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil *****, për shkak të ristrukturimit të institucionit, duke urdhëruar edhe dëmshpërblimin e tij sipas vjetërsisë në shërbimin civil, në zbatim të pikës 7 (*germa përkatëse, sipas vjetërsisë konkrete, në shërbimin civil*), të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

2. Në aktin e lirimimit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit, të shënohet në mënyrë të shprehur edhe e drejta që buron nga pika 8, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
3. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, Bashkia Gjirokastrë është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjëritjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Gjirokastrë dhe kërkuesi *****.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha